REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2019:089474
Datë:	18.02.2020
Numri i dokumentit:	00838165
	C.nr.384/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në kontestin e paditëses ..., me seli në Prishtinë, rr.”...”, nr. ..., Distrikti në Prizren, kundër të paditurit A.(I).Bnga Prizreni, me vendbanim në rrugën “...” nr. ..., për shkak të kompensimit të dëmit material, vlera e kontestit 848.35 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën 12.02.2020, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses ..., me seli në Prishtinë-Distrikti në Prizren.

II. DETYROHET i padituri A.B nga Prizreni, që në emër të kompensimit të dëmit material për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, t’ia paguajë paditëses shumën në lartësi prej 848.35 € (tetëqind e katërdhjetë e tetë euro e tridhjetë e pesë cent), si dhe në emër të shpenzimeve procedurale t’ia paguaj paditëses shumën në lartësi prej 20 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja ..., me seli në Prishtinë, rr.”...”, nr. ..., Distrikti në Prizren pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit A.(I).B nga Prizreni, për shkak të kompensimit të dëmit, përmes së cilës ka theksuar se me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1204/2016 të datës 04.04.2018, i cili është bërë i plotëfuqishëm me datë 05.06.2018, këtu i padituri është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga nenin 320 i KP, ndërsa që paditësja për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt civil. Sipas padisë, i padituri, prej datës së pavërtetuar e deri më datën 11.02.2016, në shtëpinë e tij në Prizren në adresë të lartcekur, nga komisioni i autorizuar i paditëses ishte vërtetuar se e ka shfrytëzuar energjinë në mënyrë të kundërligjshme më saktësisht të konstatur sikurse në aktgjykimin e lartcekur penal, kështu energjia e shpenzuar nuk është regjistruar me ç’rast distriktit të ... në Prizren, i shkakton dëm material në shumën prej 848.35 euro andaj edhe nga gjykata është kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia, ashtu që të detyrohet i padituri që t’ia kompensojë dëmin paditëses në shumën e lartcekur, më gjerësisht sikurse në padi.

2019:089475

Edhe përgjatë shqyrtimit gjyqësor, i autorizuari i paditëses B.P ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë si dhe provave të propozuara në padi , ndërkaq në fjalën përfundimtare ka shtuar se në këtë procedurë dhe pas administrimit të provave është provua bazueshmëria e kërkesëpadisë, për çka edhe i ka propozuar gjykatës që të njejtën ta aprovoj në tërësi si të bazuar, duke e detyruar të padituri A.(I).B nga Prizreni, që në emër të kompensimit të dëmit material si pasoj e veprës penale të shkaktuar të konstatuar me aktgjykimin e plotfuqishëm penal të lartë administraur, t'ia paguaj paditëses shumën në lartësi prej 848.35 €, si dhe në emër të shpenzimeve procedurës për taksën e paguar gjyqësore, shumën prej 20 €, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 12.02.2020.

I padituri A.B nga Prizreni në përgjigje me shkrim në padi dhe në shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë për arsyen se i njëjti nuk ka bërë asnjë lidhje apo rilidhje në përçues të rrymës apo rrjetit për përçim siç më ka akuzuar paditësja, i njëjtë thekson se në aktgjykim është cekur shtëpi por është lokal afarist dhe se nuk ka qenë pronarë i njehsorit, dhe se me pranim të lokalit nuk ka bërë asnjë ndryshim në instalim e aq më pak vepër penale të vjedhjes së rrymës, më gjerësisht sikurse në procesverbalin e datës 12.02.2020

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1204/2016 i datës 04.04.2018 i plotfuqishëm me datë 05.06.2018 dhe faturën me nr.... i datës 15.02.2016.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të tjera, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditëses është **tërësisht e bazuar.**

Në bazë të aktgjykimit të plotëfuqishëm penal të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1204/2016 të datës 04.04.2018 i plotëfuqishëm me datë 05.06.2018, gjykata e ka provuar faktin se këtu i padituri A.(I).B nga Prizreni, është shpallur fajtor pasi që ka kryer vepër penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së, me ç'rast paditëses i shkakton dëm material në shumën prej 848.35 €, më gjerësisht sikurse në këtë aktgjykim.

Nga leximi faturën me nr.... të datës 15.02.2016, gjykata ka konstatuar se dëmi të cilin i padituri i'a ka shkaktuar këtu paditëses është në shumën prej 848.35 €, më gjerësisht sikurse në këtë faturë.

Baza ligjore

Duke pasur parasysh kohën e shkaktimit të dëmit, bazuar në nenin 1057 të Ligjit të ri për Marrdhëniet e Detyrimeve (LMD) nr.04/L-007, i cili ka hyrë në fuqi me 20.12.2012, gjykata vlerëson se në këtë çështje kontestimore megjithatë zbatohet Ligji i vjetër për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i ish RSFJ-së.

Me nenin 154 al.1 të LMD-së, është paraparë se "*kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij".* Sipas nenit 14 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se "*në procedurën kontestimore*

gjykata më pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor". Po ashtu me nenin 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se " ***palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla***", ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se "*Gjykata është e autorizuar që t'i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t'i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji)…*" gjë që sipas bindjes së gjykatës, në rastin në fjalë nuk kemi të bëjmë me kërkesa të tilla.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë procedurë është provuar se i padituri A.(I).B nga Prizreni, i ka shkaktuar dëm material këtu paditëses përmes shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, për çka i padituri ka detyrim për kompensimin e këtij dëmi ndaj paditëses. Në të vërtetë paditësja i ka ofruar gjykatës si provë aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1204/2016 të datës 04.04.2018 i plotëfuqishëm me datë 05.06.2018, përmes të cilit vërtetohet fakti se këtu i padituri është shpallur fajtorë për veprën penale të vjedhjes së shërbimeve komunale nga neni 320 të KPK-së, me ç'rast edhe është konstatuar shuma e dëmit të shkaktuar. Po ashtu paditësja si provë gjykatës i'a ka parashtruar edhe faturën mbi shpenzimin e paautorizuar të energjisë elektrike me nr.... të datës 15.02.2016, e cila është hartuar konform rregullave dhe procedurave të aprovuara nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë Elektrike (ZRREE), të cilës gjykata i'a fali besimin e plotë, e përmes të të cilave prova është vërtetuar lartësia e shumës së shpenzuar e energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme nga ana e të padituri, respektivisht lartësia e dëmit që i është shkaktuar këtu paditëses nga ana e të padituri.

Mbi bazën e të lartcekurave gjykata gjeti se kërkespadia e paditëses është e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrur konform nenit 452 të LPK-së dhe atë vetëm për shpenzimet në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, siç edhe janë kërkuar nga ana e vet paditëses.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.384/2019, datë 12.02.2020

Gjyqtari,
Gëzim Shehu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.